



Stadi: 1/02/2018

Aplikim për vizë me qëllim studimesh

(për aplikantë studimesh universitare, studentë, doktorantë, studentë të PhD dhe kurse gjuhe përgatitore për studime)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht disa javë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj që brenda 4 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës (www.tirana.diplo.de).

Gjatë procedurave të aplikimit Ambasada mund të kërkojë në raste të veçanta dokumenta të tjera shtesë, që nuk përmenden në këtë fletë informacioni.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!

1.	Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	2x formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.
3.	3x fotografi	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.

4.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
5.	Dëftesa e maturës	Vërtetimi të drejtës për të vazhduar studimet e lara (diplomë, librezë studenti ose vërtetim i përfundimit të shkollës) në kopje të noterizuar, të përkthyer dhe me vulë apostille .
6.	Njoftimi i pranimit Ose Konfirmimi i aplikimit Ose Regjistrimi në kursin e gjuhës <i>+ 2 kopje</i>	Njoftimi i pranimit nga një shkollë e lartë në Gjermani në origjinal O s e Dëshmi në origjinal e konfirmimit të aplikimit nga një shkollë e lartë në Gjermani O s e Dëshmi në origjinal e regjistrimit në një kurs gjuhe përgatitor për studime universitare (pra me qëllimin e dhënies së provimit të gjermanishtes si gjuhë e huaj apo për pranim në shkollën e lartë DSH/DaF)
7.	Dëshmi e financimit <i>+ 2 kopje</i>	Vërtetim për mundësi financimi prej të paktën 720 euro në muaj për një vit depozituar paraprakisht. Shikoni për këtë udhëzimet në faqen e internetit mbi rregullat për vizë / hapja e një llogarie bankare të bllokuar: http://www.tirana.diplo.de/_Zentrale_20Komponenten/Ganze-Seiten/de/RK/Sperrkonto.html?site=27011 . Shih edhe www.x-patrio.com/ rreth llogarisë së bllokuar online <i>x-patrio</i> Alternativa <ul style="list-style-type: none"> • Përmes një burse – njoftimi i dhënies së bursës duhet të jetë në origjinal (certifikata e printuar vetëm në rastet e DAAD) ose • Një deklaratë garancie sipas §§66-68 të Ligjit për të Huajt, në të cilën një person i tretë merr përsipër me shkrim kostot përkatëse (pranë Zyrave të të Huajve në Gjermani mund të gjenden formularët e deklaratave të tilla të garancisë). Ose • Përmes derdhjes së shumës përkatëse në një llogari bankare të bllokuar në bankat e mëposhtme shqiptare: <ul style="list-style-type: none"> - Intesa Sanpaolo Bank Albania http://www.intesasanpaolobank.al - ProCreditBank http://www.procreditbank.com.al
8.	Curriculum Vitae (nëse kërkohet) <i>+ 2 kopje</i>	

9.	Shkresë motivimi <i>+ 2 kopje</i>	
10.	Dëshmi e gjuhës gjermane (e panevojshme kur studimet janë në anglisht) <i>+ 2 kopje</i>	Dëshmi për përvetësimin e suksesshëm të njohurive të gjuhës gjermane minimalisht në nivelin B1 sipas Kuadrit Evropian të Referencave GER. Përgjatim: nëse përmes njoftimit të pranimit konfirmohet, se ky ka qenë kusht për pranimin në universitet ose se është planifikuar ndërkohë një kurs përgatitor gjuhe për studimet.
11.	Dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm <i>+ 2 kopje</i>	Kjo dëshmi duhet të paraqitet për të gjithë periudhën e qëndrimit në momentin e tërheqjes së vizës.
12.	Minorenët	Në rastin e minorenëve nevojitet edhe certifikata e tyre e lindjes (certifikata me vulë apostille dhe përkthim në gjermanisht) + 2 kopje dhe një deklaratë e noterizuar e dakordësisë së prindërve për largimin e fëmijës me qëllim studimesh + 2 kopje

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.